



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-20533/20
Kaçanik, 01.09.2020

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VII-të** (Shtatë) e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VI e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 01 Shtator 2020. Për shkak të distancës fizike lidhur me pandeminë Covid-19, mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës komunale, në sallën e kuvendit të komunës, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve sa ka KPF, pjesëmarrës në mbledhje ishin të gjithë anëtarët: Kemal Mërseli, Nexhat Loku, Pranverë Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, Selim Reka, Hafize Sallahi dhe Albana Troni.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Nënkryetari i Komunës-Ylber Bajra, drejtorët e drejtorive komunale; Bahri Selimi dhe Ramadush Osmani.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,

Procesmbajtës: Arbnora Kuka, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e VII-të (Shtatë) të Rregullt të KPF-a për vitin 2020, data 01 Shtator, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Raporti i Auditorit për pasqyrat financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin 2019;
3. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV 2019;
4. Propozim Vendim për rialokimin dhe transferin e mjeteve nga rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2020; dhe
5. Raporti i punës së Shtabit komunal për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut.

Lidhur me rendin e punës, kemi kërkesë të drejtorit të Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim që të futet në rend pune edhe një pikë e rendit të punës, "Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020". Kjo ka të bëjë me disa mjete që kanë mbetur nga një projekt dhe që do të rialokohen me një projekt tjetër dhe me qëllim që të mos vonohen me këtë projekt. Kërkojë edhe mendimin tuaj për futjen ose jo në rend pune të kësaj pike.

z. Nexhat Loku, Unë pajtohem që kjo pikë të futet në rend pune, që të mos vonohen projektet të cilat janë paraparë.

znj. Pranvera Loku-Zharku, Edhe unë pajtohem që të futet në rend pune, meqë e kemi edhe një pikë tjetër lidhur me rialokimet e mjeteve.

z. Ekrem Kyçyku, Kemi raste të shpeshta të futjes në rend pune , mirëpo jam për që të futet në rend pune kjo pikë.

znj. Albana Troni , Edhe unë jam për që të futet në rend pune kjo pikë.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Me futjen në rend të punës edhe këtë pikë, e qes në votim për aprovim. Të gjithë vonuan njëzëri dhe në saje të kësaj del konstatimi se KPF:

APROVOJ

Rendin e propozuar të punës, në përbërje prej 6 pikave dhe atë siç vijon :

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Raporti i Auditorit për pasqyrat financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin 2019;
3. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV 2019;
4. Propozim Vendim për rialokimin dhe transferin e mjeteve nga rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2020;
5. Raporti i punës së Shtabit komunal për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut; dhe
6. Propozim Vendim për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e,

APROVOJ

Procesverbalin e mbledhës së VI-të (Gjashtë) të Rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 03 Gusht 2020 / Lënda: 01Nr. 60/01-17013/20.

2. Raporti i Auditorit për pasqyrat financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin 2019 ;

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Siç e dimë komunat çdo vit kryejnë auditime nga jashtë dhe një raport i auditorit i dërgohet Kryetarit dhe një Kuvendit. Ky raport është vetëm si njoftim nga auditori i jashtëm për pasqyrat vjetore financiare të komunës për vitin e përfunduar 2019. E hapi diskutimin.

z. Ekrem Kyçyku, Përshëndetje për të gjithë. Auditori ka dhënë opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes. Theksimi i çështjes është se pagesat e realizuara nga Thesari në emër të komunës në bazë të vendimeve gjyqësore/ përmbartimore, në vlerë prej 153,425€, janë paguar dhe regjistruar në kategoritë joadekuate ekonomike. Auditori edhe kësaj radhe ka gjetur 10 çështje që kanë bëjnë me mangësi e parregullsi. Çështja A1- Keq klasifikim i shpenzimeve. Komuna ka paguar dhe ka regjistruar shpenzime në kategori joadekuate. Çështja A2- Dobësi në dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Komuna nuk ka procedura të parapara me akte nënligjore për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës, ndërsa kishte dhënë

me qira pronat komunale për periudhën 01.01.2019 deri më 21.12.2019, duke vazhduar kontratat paraprake pa procedura. Kjo është evidentuar në 4 nga 5 mostrat e testuar. Kontratat janë nënshkruar edhe pse qiramarrësit nuk kishin kryer obligimet paraprake. Kjo është në kundërshtim me ligjin 04/l-044 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim Çështja B1- Mangësi në evidencat për pronat me qira. Drejtoria e Urbanizmit, mbanë evidencë për pronat e dhëna me qira, mirëpo ato nuk janë të plota për të siguruar se të gjitha vlerat janë regjistruar saktë, pasi që dallojnë të hyrat e regjistruara në freebalance me ato të evidentuara në regjistrin e brendshëm. Po ashtu nuk kishte kartela financiare për pronat e dhëna me qira. Çështja C1 – Mangësi në angazhimin e stafit me marrëveshje për shërbime të veçanta. Komuna gjatë vitit 2019 kishte të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta 19 punonjës. Edhe pse ishin përdorur procedura të thjeshta rekrutimi, 12 prej tyre ishin nga vitet paraprake, kryesisht nga viti 2014. Këto angazhime ishin për pozita jo specifike të punës ndërsa duhet të jenë pozita specifike. Çështja A3 – Dobësi në menaxhimin e subvencioneve. Te thirrja për aplikim në “Fushën e kulturës rinisë dhe sportit” nuk ishin kërkuar kriteret e matshme dhe specifike për përzgjedhjen e përfituesve potencial. Në tri raste, zyrtarët nuk arrijnë ta dëshmojnë se si është bërë vlerësimi dhe se nuk janë ofruar procesverbalet nga komisioni për vlerësim siç është e paraparë me rregulloren e brendshme të komunës. Unë e di që edhe anëtarët e komisionit nuk janë ftuar në mbledhje. Çështja A4 – Dobësi në procesin e prokurimit. Gjatë testimit të 5 mostrave të pajtueshmërisë janë vërejtur se në dy raste komuna kishte zhvilluar aktivitete të prokurimit që nuk ishin të përfshira në planin e prokurimit dhe nuk e kishte njoftuar Agjensionin Qendror të Prokurimit. Në tre projekte për punë komuna nuk kishte hartuar projektin ekzistues, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit vetëm në bazë të para masës dhe para llogarisë. Çështja B2 ka të bëjë me mangësi në menaxhimin e regjistrave të pasurive dhe shpalosjen e informatave në Pasqyrat financiare vjetore. Çështja B3 ka të bëjë me ka të bëjë me rritjen e vlerës së llogarive të arkëtueshme dhe shpalosje jo e saktë e tyre në PFV. Çështja A5 – Mangësi në prezantimin e obligimeve në PFV. Çështja A6 ka të bëjë me mos kompletimin e Njesisë së Auditorit të Brendshëm. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019, sipas auditorit; 4 rekomandime janë zbatuar, 1 ishte në proces të zbatimit, 3 nuk janë zbatuar ende dhe 3 rekomandime konsiderohen të mbyllura.

z. Nexhat Loku, Sipas opinionit të auditorit të përgjithshëm është opinion i pamodifikuar, kjo nënkupton se është mirë. Sa i përket pagesës për shpronësim të tokës janë procedura të gjykatës përmes përmbauesve. Çështja B1 – Mangësi në evidencat për pronat me qira, ka prona që janë dhënë me qira që nga viti 1997, i ka dhënë shpjegimet edhe drejtori. E gjetura 10 – Mos kompletimi i njesisë së auditorit të brendshëm, që kjo njësi të ketë 3 auditor. Ministria e financave me sa e dimë nuk lejon me shumë sesa numri i caktuar i punëtorëve, në bazë të numrit të banorëve.

Drejtori i DEFZH- Bahri Selimi, Kur tërhiqen mjetet nga thesari me urdhër të përmbauesit, ato tërhiqen aty ku ka mjete dhe aty regjistrohen. Ne jemi në dijeni se është keq klasifikim, se është dashur të tërhiqen nga investimet kapitale, mirëpo kjo bëhet pa pëlqimin e komunave. Sipas Ministrisë së Financave ne duhet t'i planifikojmë këto mjete.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, A jeni që Raporti i auditorit për pasqyrat financiare të komunës së Kaçanikut për vitin 2019 t'i përcillet Kuvendit? Të gjithë anëtarët e KPF-së votuan njëzëri, kështu që konstatohet që KPF vendosi që:

Raporti i Auditorit për pasqyrat financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin 2019 t'i përcillet Kuvendit.

3. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV 2019

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Bashkë me Raportin e auditorit të përgjithshëm, drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim bënë edhe Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga zyra Kombëtare e Auditimit. A keni diçka për diskutim? Nëse nuk keni diçka, a jeni të pajtimit që Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV 2019? Të gjithë votuan njëzëri dhe me këtë konstatohet që KPF:

Aprovoj

Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV 2019 ; dhe i nejtë i

Rekomandohet

Kuvendit për shqyrtim dhe aprovim

4. Propozim Vendim për rialokimin dhe transferin e mjeteve nga rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2020

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Fillimisht them se këto rezerva komunale kanë rrjedhë nga mos përmbushja e realizimit të pagave të cilat kanë qenë të planifikuara për këtë vit. Me kërkesë të kryetarit të komunës në asociacionin e komunave që të mos i merren mbrapsht por t'i lihen komunave sepse shumica e komunave kanë probleme me gjykata për pagesën e shujtave në drejtoritë e arsimit që dalin nga kontrata kolektive. Te zyra e Kuvendit janë marrë 72 mijë euro. Hapi diskutimin.

z. Bahri Selimi, Arsye e rezervave komunale është pagesa në Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës që do t'i bëhet mësimdhënësve për shujtat që dalin nga kontrata kolektive e vitit 2017. Nëse keni ndonjë propozim tjetër mund të bëjmë ndonjë vendim tjetër. Padia që kemi pranuar është gati 700 mijë euro. Ne i kemi nda 425 mijë euro për Drejtorinë e Arsimit. Te drejtoria e shëndetësisë nuk kemi tërheq mjete sepse i duhen drejtorisë për pandeminë. Shuma 538,639€ që i riallokojmë janë nga rezerva e pagave dhe mëditjeve.

z. Selim Reka, Kërkoj falje për vonesën në takim. Një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit. Fondi emergjent nëse nuk shpenzohet, a bartet për vitin vijues?

Drejtori i DEFZH- Bahri Selimi, Fondi emergjent është grant suficitar. Nëse tepron mund ta shfrytëzojmë për pandeminë Covid-19, nuk do ta kthejmë suficit.

z. Selim Reka, Kam një kërkesë që fondin emergjent të bëhet i përhershëm, sepse komunat kanë nevojë dhe vazhdimisht të shtohet.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Nëse nuk mbeteni keq në mbledhjen e mjeteve, 10,000.00€ të mbeten për Kuvend, pasi që kemi nevojë për disa renovime në sallën e Kuvendit.

Drejtori i DEFZH- Bahri Selimi, Gjykata e ka pranë vendimin për pagesë afër 700,000.00€ për mësimdhënësit, mirëpo Drejtoria e Arsimit është organizuar mirë dhe i ka shikuar të gjitha.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, A do ta kontestoni vendimin e gjykatës?

Drejtori i DEFZH- Bahri Selimi, Ne do ta rivlerësojmë vendimin.

z. Ekrem Kyçyku, Për çfarë periudhe do të paguhet? Këto që nuk kanë bërë padi , a ju takon pagesa?

Drejtori i DEFZH- Bahri Selimi, Ju takon të gjithëve. Pagesa bëhet prej vitit 2017, kur është nënshkruar marrëveshja kolektive.

Nënkryetari i Komunës, Ylber Bajra, Kjo marrëveshje është e turpshme. Pa marrë parasysh, të gjithëve ju takon pagesa.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Nëse nuk keni diçka tjetër për diskutim a pajtoheni që kjo pikë t'i përcillet Kuvendit për shqyrtim? Të gjithë votuan njëzëri dhe me këtë konstatohet se KPF

Aprovoj

Propozim Vendim për rialokimin dhe transferin e mjeteve nga rezerva komunale sipas buxhetit të vitit 2020 dhe i njejt i

Rekomandohet

Kuvendit për shqyrtim dhe aprovim

5. Raporti i punës së Shtabit komunal për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut

z. Ekrem Kyçyku, Falenderoj gjithë stafin e QKMF-së për punën që bëjnë. Gjendja në QKMF është e keqe, nuk kanë mjete. Kërkoj nga ju të dërgohet material për QKMF dhe të bëhet dezinfektimi i QKMF.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Nëse nuk keni diçka tjetër për diskutim, a jeni të pajtimit që ky raport t'i përcillet Kuvendit? Të gjithë votuan njëzëri dhe me këtë konstatohet se KPF vendosi që, **Raporti i punës së Shtabit komunal për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut t'i kalojë Kuvendit në formë informate.**

6. Propozim Vendim për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020.

z. Bahri Selimi, Nëse është në kundërshtim me ligjin ne mundemi që këtë pikë të shtyjme edhe për mbledhjen tjetër, mirëpo ne menduam që të mos na dështon një projekt tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Nëse nuk keni diçka tjetër për diskutim, a jeni të pajtimit që kjo pikë t'i përcillet Kuvendit? Të gjithë votuan njëzëri dhe me këtë konstatohet se KPF

Aprovoj


Propozim Vendim për rialokimin e mjeteve sipas buxhetit të vitit 2020 dhe i njejt i

Rekomandohet

Kuvendit për shqyrtim dhe aprovim

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka. Mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:50. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët. Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me datë 08 Shtator 2020 në ora 11:00.

Procesmbajtës:
Arbnora Kuka



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

